



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesa për Kushte Ndërtimore me nr. protokollit **6828-2/25** të datës **07.10.2025** nga Aplikuesi Korporata Energjetike e Kosovës - KEK me përfaqësues Abedin Kabashi (i autorizuar), ku planifikohet të ndërtohet “Impianti i Masave Sekondare për Reduktimin e Oksideve të Azotit, SNCR” dhe infrastruktura përcjellëse në parcelat -00310-2, -00311-2 dhe -00312-2 Zonën Kadastrale Obiliqi P-72614055, me sipërfaqe totale prej 10.385 m² që ndodhen në Komunën e Obiliqit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Projektit “Impianti i Masave Sekondare për Reduktimin e Oksideve të Azotit, SNCR” dhe bazuar në shkresën e KEK-ut, Projekti në fjalë është në kuadër të projektit të ndrrimit të Elektrofiltrave në TC-B i financuar nga Bashkimi Evropian,

Për njoftimin tuaj, ndërtimi i projekti për “Impianti i Masave Sekondare për Reduktimin e Oksideve të Azotit, SNCR” është pajisur me Kushte Ndërtimore dhe Leje Ndërtimore nga kjo ministri në vitin 2022, por për disa arsye të ndryshme, ky projekt nuk ka filluar të zbatohet dhe ende nuk është ndërtuar dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, sërish është parashtruar kërkesa për kushte ndërtimore.

Komentet lidhur me këtë propozim mund të dorëzohen deri më dt.27.03.2026 në adresën elektronike: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:	
Kushtet Ndërtimore të propozuara: Projekti, “Impianti i Masave Sekondare për Reduktimin e Oksideve të Azotit, SNCR”, ZK Obiliq, Komuna e Obiliqit	
Situacioni i gjërë dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Sipas Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, projekti në fjalë përputhet plotësisht me synimet, objektivat dhe aktivitete që parashihen në këtë dokument.	
b. Vija rregulluese.	- m
c. Vija e ndërtimit.	-m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Sipas Situacionit
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	Sipas Situacionit
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	4.60%
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	65.04%
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	/
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Strukturat konstruktive mbajtëse – nga konstruksioni i çelikut, Mbulesat – sandwich panele, Fasadat – sandwich panele dhe
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	